

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë , KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. publikon këtë :

## K O N K U R S

**Pozita:** Kryesues i Departamentit për Shërbime me Konsumatorë

**I përgjigjet:** Zyrtaritë të Lartë Financiar

**Ekzekutues:** 1(Një).

**Kohëzgjatja e Kontratës:** Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhoj tërë departamentin
- Siguroj komunikimin dhe ndërlihdjen ndërmjet kompanisë dhe publikut (Konsumatorëve).
- Siguroj performancë të mirë të shërbimeve për publikun.
- Siguroj komunikimin me të gjitha departamentet tjera.

### Më detajisht kjo përfshin:

- Organizon, kordinon ,monitoron dhe punon në Departamentin SHK.
- Pergaditë dhe ekzekuton planet vjetore/mujore/javore të aktiviteteve të SHK.
- Raporton me gojë dhe me shkrim për rezultatet e punës në Departamentin SHK.
- Kordinon punën me sektorët tjerë te kompanisë.
- Siguron nënshkrimin e kontratës në mes të klientit dhe kompanisë.
- Propozon dhe ndërmerr veprime kundër prishjeve të kontratave nga ana e konsumatorit.
- Organizon dhe mbikëqyrë procesin e faturimit.
- Organizon, monitoron procesin e inkasimit dhe pregaditë raporte mujore.
- Ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallën e inkasimit.
- Monitoron për se afërmi debitorët (borgjëlinjë) dhe ripagesat e tyre.
- Organizon punën e ekipeve të çkyqjes.
- Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhërit.
- Organizon punën e ekipeve të inspektionit, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe serioze.
- Vendos dhe monitoron procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorit / kërkesat / aplikimet.
- Trajton dhe proceson ankesat e konsumatorëve.
- Merret me kërkesat për kyçe të reja, pregaditë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.
- Zhvillon procesin e vetëdijesimit të popullatës.
- Pregaditë dhe ekzekuton anketa të konsumatorëve për të vlerësuar performancën dhe nivelin e kënaqësisë më shërbimet e ofruara.
- Rishikimi I nevojave për trajnim të stafit.
- Monitoron performancën e personelit dhe propozon masa koresponduese.

**Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:**

- ❖ Diplomë universitare,
- ❖ Punëtor i aftësuar ose i trajnuar në fushën e Menaxhimit,
- ❖ Demonstron aftësi në të kuptuarit dhe aplikuarit të parimeve bazë të Menaxhimit
- ❖ Dëshmi për përvojën e punës në fushën e Menaxhimit të deshmuaara me referencat e prezentuara.
- ❖ 2 vjet përvojë pune te deshmuaara nga Trusti .
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetime;
- ❖ Letër motivimin;

*Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore te KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr" Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web – faqen " Hidrodrini" Sh. A. [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com) .*

*Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU " Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. " Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës). Shpallja do të jetë e hapur 15 Ditë (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)*

*Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale përverifikim para komisionit intervistues.*

*Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.*

*Aplikacionet e derguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU " Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.*